

Buxheti i Qytetarit 2017



Mesazh për Lexuesin



Z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave

Të dashur qytetarë,

Buxheti 2017 ka në fokus të veçantë mbështetjen e konsumit dhe përshejtimin e rritjes ekonomike. Rritja në 2017 do të arrijë 3.8%, gati 4-fishi i asaj që ishte në vitin 2013. Në të njëjtën kohë, buxheti 2017 siguron mbështetjen e reformave, uljen e borxhit publik, forcimin e kuadrit makroekonomik dhe vënien nën kontroll të rrezeve makro-fiskale.

Pas tre viteve në të cilat ekonomia kaloi nga kriza, në konsolidim të financave publike dhe kthim të trendit të rritjes ekonomike pozitive, buxheti i vitit 2017 është buxheti i rritjes së pagave dhe pensione. Për herë të parë do të injektohen rreth 10 miliard lekë për rritjen e pagave dhe pensione që pritet ti japin një shtysë pozitive të mëtejshme konsumit dhe rritjes ekonomike.

Buxheti 2017 mbështet rritjen e qëndrueshme ekonomike duke siguruar dhe një nivel optimal të investimeve publike, rreth 5% e Prodhimit të Brendshëm Bruto pa përfshire këtu investimet e qeverive vendore.


Projektbuxheti i vitit 2017 do të vazhdojë mbështetjen e reformave strukturore me rreth 20 miliardë lekë duke financuar edhe reformën në drejtësi dhe reformën e ujit krahas atyre të administratës publike, të energjisë, pensione, pronave, decentralizimit dhe të shëndetësisë. Të gjitha këto reforma kanë përmirësuar dhe do të vazhdojnë të përmirësojnë ndjeshëm jetën e qytetarëve dhe klimën e biznesit në Shqipëri.

Buxheti i vitit 2017 është i pari i bazuar në ligjin e ri organik që prezanton konceptin e rregullave fiskale, ndër të tjera duke bërë të detyrueshëm uljen e borxhit nga viti në vit. Në 2017 borxhi publik ulet me thajse me 3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, nga 71.8% që është i pritshmi i këtij viti, në 69.1% në vitin 2017. Ky buxhet ka deficietin më të ulët të arritur ndonjëherë prej rreth 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto; balancën korrente më pozitive në 25 vite me rreth 2.9%, që kapërcen madje dhe kufirin e rregullit të artë.

Ky është një buxhet për qytetarin. Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, ulja e kostove, garantimi i rritjes ekonomike, rritja e pagave dhe pensione, përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve, ulja e borxhit publik dhe reformat, të gjitha këto përbëjnë platformën mbi të cilën mbështetet aspirata europiane e qytetarëve shqiptarë, e që tani është më afër se asnjëherë tjetër.

Transparencë dhe Pjesëmarrje

Një proces buxhetor transparent, jo vetëm përmirëson procesin politik-bërës për strategjitë dhe reformat kryesore por, nëpërmjet një pjesëmarrje aktive të taksapaguesve dhe përfituesve nga politikat buxhetore, lehtëson implementimin e suksesshëm të tyre.



Studimet kanë argumentuar se vendet që kanë rritur transparencën e buxheteve të tyre kanë një nivel korrupsioni më të ulët dhe njëkohësisht një implementim më të mirë të politikave ekonomike e sociale dhe të efijçencës së shpenzimeve dhe investimeve publike.

Ligji i ri Organik i Buxhetit

Gjatë vitit 2015 dhe fillimit të vitit 2016, Ministria e Financave ndërmori procesin e rishikimit të Ligjit Organik të Buxhetit (LOB), ndryshe Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Risitë e Ligjit Organik janë:

Barazia gjinore

Rregullat e arta të ligjit të menaxhimit të buxhetit

- 1.Raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës;
2. Krijimi i një fondi kontigjence me vlerë jo më pak se 0,7 % e shpenzimeve totale të buxhetit;
- 3.Kur rritja reale e PBB është të paktën 5%, deficitit i borxhit nuk mund të jetë më i lartë se 2%;
- 4.Të ardhurat nga privatizimi do të shkojnë 50% për uljen e borxhit dhe pjesa tjetër për investime publike;
- 5.Ndryshimet e ligjeve fiskale me efekt në të ardhurat buxhetore do të bëhen një herë në vit.
- 6.Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara cdo vit në ligjin e buxhetit

Minimizimi i riskut për veprimet ekstra-buxhetore;

Kontrolli i angazhimeve shumë-vjeçare;

Harmonizimi i proceseve të planifikimit dhe zbatimit/rialokimit të projekteve të investimeve publike;

Vendosja e rregullave për vlerësimin e plotë të projekteve të investimeve publike, mbi një vlerë të caktuar limit.

Parimet e Buxhetit

Përgjegjësi të
qarta për
menaxhimin
operacional

Transparenca,
gjithëpërfshirja,
uniteti dhe
universaliteti në
menaxhimin e
sistemit buxhetor e
të fondeve speciale

Përdorimi ekonomik,
efiçent dhe efektiv i
burimeve publike

Shpërndarje e
burimeve, në
përputhje me
objektivat strategjikë
të Këshillit të
Ministrave

Respektimi me
reptësi i tërësisë së
procesit

Barazia
Gjinore

Disiplinë fiskale, në
përputhje me
stabilitetin
makroekonomik
dhe zhvillimin e
qëndrueshëm
ekonomik dhe
social

Fazat e Buxhetit

Planifikimi



Udhëzim për përgatitjen e buxhetit dhe parashikimet buxhetore.

Projekti i Programit Buxhetor

Publikimi i buxhetit dhe programit vjetor.

Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike.

Udhëzim plotësues për përgatitjen e Buxhetit.

Projekt Buxheti Vjetor.



Miratimi



Këshilli i Ministrave dërgon për miratimin në Kuvend.

Diskutohet, bëhen ndryshimet e nevojshme dhe miratohet.

Përgatiten dhe miratohen buxhetet vendore.

Botohet në fletoren zyrtare.



Zbatimi



Udhëzim për zbatimin e buxhetit.

Shpërndarja e fondeve buxhetore.

Mbyllja e Buxhetit.



Kontrolli



Kontabiliteti dhe raporti.

Raporti vjetor i zbatimit.

Miratimi i raportit vjetor dhe publikimi.

Raportet e zbatimit të buxhetit.

Kontrolli i brendshëm financiar publik.

Auditimi i brendshëm.

Inspektimi financiar.

Auditimi i jashtëm.

Viti buxhetor, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, fillon nga data 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Rritja ekonomike
në 2017
parashikohet të
jetë 3.8%

Të ardhurat
parashikohen më
një rritje prej 6.9%
në 2017,
krahasuar me
2016

**Objektivat
makroekonomike
2017**

100 milionë dollarë
(në 12 muaj) do të
shkojnë për rritjen e
pagave dhe
pensioneve

Deficiti do
të jetë rreth
2% e PBB

20 miliardë lekë për
mbështetjen e
reformave thelbësore
për ekonominë

Borxhi publik
do të ulet me
pothuaj 3%,
në 69.1%

Rritja nominale
e PBB-së do të
jetë 6.3%

Buxheti i Reformave

Financimi dhe Impakti i tyre

Reforma në Drejtësi



Fond prej
**500 Milionë
Lekësh**

- Krijimi i një legjislacioni të konsoliduar, të sistemuar me standardet ndërkombëtare të cilat do të zbatohen njëtrajtësisht nga institucionet e sistemit të drejtësisë;
- Përmirësimi jo vetëm i profesionalizmit dhe etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve por edhe i sistemeve të matjes së performancës;
- Një sistem drejtësie ku aktorët kryesorë të tij, zotërojnë integritetin moral dhe aftësitë profesionale për të zbatuar standardet e së drejtës europiane në Shqipëri.

Reforma në Sektorin e Ujit

Investime publike

Përmirësim rrënjësor i menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellësve dhe kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit.

Subvencion për ndërmarrjet e UK në shumën **1.000.000.000 Lekë**

Mbështetje për zbatimin e reformës për Sha UK (investime publike) në shumën **144.609.000 Lekë**.

Reforma në Administratën Publike

Ofrimi i shërbimeve përmes qasjes “me në qendër qytetarin”;

Hapje e dy qendrave të reja të integruara për ofrimin e shërbimeve publike në qytetet Durrës dhe Elbasan;

Thjeshtëzimi i procedurave administrative, shërbime elektronike dhe online;

Politikë për rritjen e pagave të punonjësve publik.

Reforma Territoriale dhe Administrative

Rritja e Buxhetit Vendor nga 2.1% të PBB-së që zinte para reformës në 3.1% të PBB-së në projekt-buxhetin e vitit 2017;

Ulja e kostove për qytetarët;

Rritja së eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike;

Zhvillimi ekonomik lokal;

Nxitja e zhvillimit vendor.

Transferta e pakushtëzuar do të jetë rreth 20 % më e lartë se e vitit 2016.

Nga vijnë paratë e Buxhetit?

Totali i të Ardhurave	436 Miliardë Lekë	27.3% të PBB
Të Ardhurat nga Ndhimat	13.8 Miliardë Lekë	0.9 % të PBB
Të Ardhurat Tatimore	397.8 Miliardë Lekë	24.9 % të PBB
Të Ardhurat JoTatimore	24.4 Miliardë Lekë	1.5 % të PBB
Të ardhurat janë rritur me 6.9% në krahasim me 2016		

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të Ardhurave



Aksioni kundër informalitetit



Politika Fiskale

Ndryshimet në Paketën Fiskale:

Aplikimi i Akcizës për gazin e lëngshëm; **+0.6 miliardë lekë**

Reduktimi i akcizës për duhanin prodhim vendi; **+0.075 miliardë lekë**

Reduktim i Rentës minerare për mineralin e destinuar për përpunim; **-0.01 miliardë lekë**

Reduktimi i disa taksave doganore për industrinë fason; **- 0.060 miliardë lekë**

Korrektimi i akcizës për purot dhe cigarillos; **+0.004 miliardë Lekë**

Rritja e kushtëzimeve për përfitimin e rimbursimeve të akcizës për përmbajtje BIO në karburante;

Përmirësime metodike të kontrollit të bazës së taksimit të rentës minerare.

Burimet e financimit të Defiçitit Buxhetor

Çfarë është Defiçiti Buxhetor?

Të ardhurat publike < Shpenzimet publike

⋮

Për të ekuilibruar llogaritë, Defiçiti Buxhetor financohet me Borxh

⋮


Huamarrja e Brëndshme do të arrijë vlerën prej:

19,759 Milionë Lekë ; 1,2 % e PBB-së

&

Huamarrja e Jashtme do të arrijë vlerën prej:

11,440 Milionë Lekë; 0.8% e PBB-së




Financimi i Borxhit



■ Hua e Brëndshme (60%) ■ Hua e Jashtme (40%)

Ku shkojnë paratë e Qytetarëve?

(% të PBB-së)



Shëndetësia



Prioritete për vitin 2017

1,260 mijë rezidentë në Shqipëri, do përfitojnë nga kontrolli bazë për grupmoshën 35 - 70 vjeç;

Shpenzimet publike të shëndetësisë për banorë, do të rriten nga 12,295 lekë në 2013 në 16,000 lekë në 2017;

Tarifat e vizitave dhe ekzaminimeve për personat e pasiguruar, janë ulur në jo më shumë se 300 lekë, nga deri 5 mijë lekë që ishte;

Në 2017, financimi publik për shëndetësinë parashikohet të jetë rreth 2,9 % e PBB-së, ndër nivelet më të larta të financimit në 25 vjet;

600 mijë persona të pasiguruar përfitojnë nga rimbursimi i barnave;

Mjeku i familjes do jetë falas për këdo.

Arsimi



Në vitin 2017 do përfitojnë:

64,000 nxënës në arsimin parauniversitar

3100 punonjës arsimorë

12,300 studentë




Ndëtime/ Rikonstruksione në vazhdim nga viti 2016

43 objekte shollore në arsimin parauniversitar
+
Zyra arsimore në rrethe
=
1.5 miliardë Lekë

Arsimi Universitar
19%
6,643,001 Lekë

Arsimi i Mesëm
18%
6,333,272 Lekë



Arsimi Bazë
59%
20,477,305 Lekë

Prioritete për vitin 2017

Ndëtime të reja dhe Rikonstruksione

35-40 objekte shkollore -> 240 klasa

Përfitojnë:
5,000-5,500 nxënës dhe 350 mësues

Blerje pajisjesh

80 objekte shkollore->450 klasa

Përfitojnë standarte të reja 10,000 nxënës dhe 500 mësues

50 laboratorë mësimorë/ kërkimorë shkencorë për Institucionet e Arsimit të Lartë

Laboratorë Shkencorë

90 laboratorë -> 30 shkolla në arsimin parauniversitar

Përfitojnë:
4000 nxënës dhe 200 mësues

Laboratorë IT

10 Biblioteka Dixhitale për laboratorë IT

Infrastruktura

Prioritete për vitin 2017

Rritja dhe përmirësimi i sistemit të rrjetit rrugor dhe mirëmbajtjes:

- Ndërtimi i rrugës Qukës -Qafë Pllaçe;
- Ndërtimi i rrugës Qaf Thanë-Lin-Pogradec;
- Unaza e Re e Tiranës (segmenti jug-perëndim);
- Ndërtimi i by-Pass-it Fier;
- Ndërtimi i by-Pass-it Shkodër;
- Ndërtimi i by-Pass-it Vlorë;
- Ndërtimi i rrugës F.Kruje - Thumanë;
- Ndërtimi i Unazës Peshkopi;
- Ndërtimi i Unazës Podradec;
- Ndërtimi i segmentit Harku Berdicë-Velipojë;
- Ndërtimi i segmentit Elbasan-Cërrik-Belsh-Berat, etj.

Furnizimi me ujë dhe kanalizime përmes riorganizimit të shërbimit sipas reformës administrative territoriale:

- Projekti i kanalizimeve të Tiranës së madhe;
- Ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë i plazheve;

Infrastruktura Hekurudhore:

- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Librazhd-Prrerjas.
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës;
- Terminali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i një linje të re hekurudhore Tiranë-Rinas.

Transporti Detar:

- Thellimi i kalatës së portit detar Sarandë.

Mirëqënia dhe Kohezioni Social

Prioritete për vitin 2017

Do të ndërtohen dhe rikonstrukturohen 13 Shkolla të Arsimit Profesional dhe do të kompletohen me bazën prodhuese dhe pajisjet e nevojshme;

Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së trupës mësimore të Arsimit dhe Formimit Profesional për t'iu përshtatur zhvillimeve të reja teknologjike;

25% më shumë pjesëmarrës në sistemin e arsimit profesional se viti 2016;

Skelet-kurrikula dhe Programe për kurse, të hartuara në përputhje me nevojat tregut të punës;

Garantimi i standardeve të shërbimeve sipas kuotave të përcaktuara me ligj për 1,094 klientët rezidencialë e ditorë të 28 institucioneve të përkujdesit shoqëror, në të cilat trajtohen fëmijet jetim, të moshuar të braktisur, viktimat të trafikimit, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe viktimat të dhunës në familje;

Në Programet e Nxitjes së Punësimit do të marrin pjesë rreth 6 mijë punëkërkuar të papunë;


Nga trajnimet e formimit profesional do të përfitojnë rreth 16.200 persona;

Për punëkërkuar të papunë, do të kryhen rreth 16.700 ndërmjetësime për punë.



Bujqësia

Mbështetja Buxhetore



Prioritete për vitin 2017

Parashikohet kompletimi i proceseve të rehabilitimit të skemave ujitëse kryesore;

Vazhdimi i projektit të Bankës Botërore dhe investimeve të brendshme, për të mundësuar objektivin për ujitje në 225,000 ha tokë bujqësore;

Do të vazhdojë procesi i identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve;


Do të ristrukturohet dhe modernizohet flota e peshkimit nëpërmjet projektit IPA II;

Projekt me financim të huaj "IPARD II", për mbështetjen e fermerëve

Mjedisi

Shpërndarja Buxhetore

- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi
- Programe për Mbrojtjen e Mjedisit
- Administrimi i Pyjeve



Prioritete për vitin 2017

Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit të Mjedisit Urban;

Monitorimi i Cilësisë së Ujërave;

Hartimi dhe përmirësimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës;

Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të pushtetit vendor në mbrojtjen e mjedisit;

Integrimi i ndryshimeve klimatike në sektorët e energjisë, ujërave, bujqësisë, zhvillimit urban dhe infrastrukturës;

Mbrojtja dhe përmirësimi i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Tokësore dhe Detare;


Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe eliminimi i gjetisë së paligjshme;




Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara;

Ndërtimi i Regjistrit unik kadastral kombëtar.

Zhvillimi Urban

Mbështetja Buxhetore



	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	457,000 Lekë
	Planifikimi Urban dhe Strehimi	1,697,900 Lekë
	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	9,500,000 Lekë

Prioritete për vitin 2017

Planifikimi Urban

Hartimi i planeve të përgjithshme vendore në 10 bashki të reja;

Rivitalizimin urban dhe rijetësimin e infrastrukturës në bashkitë: Tiranë, Korçë, Belsh dhe Himarë;

Strehimi

Rikonstrukcionin e 185 banesave të komunitetit Rom dhe Egjyptian në bashki;

Rehabilitimin e godinave ekzistuese të dala jashtë funksionit fillestar, nga të cilat pritet të përfitojnë 162 familje të pastreha;

Subvencionimin e interesave të kredive me përfitues 4300 familje;

Legalizimet

Intensifikimin i procesit për legalizimin e rreth 30.000 objekteve të reja në zonat masive informale deri në muajin Maj 2017

Përmbledhje

Buxheti i Rritjes Ekonomike

Rritja përshpejtohet në 3.8%, ose rreth katërfishi i asaj që rezultoi në vitin 2013;

Buxheti i Reformave

Rreth 20 miliardë lekë për akomodimin e reformave thelbësore për ekonominë: (i) reforma në drejtësi, (ii) reforma në administratën publike, (iii) reforma në pensione, (iv) reforma e pronave, (v) reforma e decentralizimit dhe (vi) reforma e ujit;

Buxheti i rritjes së pagave dhe pensioneve

Për herë të parë programohen rreth 100 milionë dollarë (të shtrira në 12 muaj) për rritjen e pagave dhe pensioneve gjatë vitit 2017 dhe në vijim;

Buxheti i investimeve publike

Buxheti 2017 siguron nivel optimal të investimeve publike me rreth 5% e PBB;

Borxhi publik

Në vitin 2017, borxhi publik do të ulet në rreth 3% të PBB-së;

Balanca Primare

Programohet me suficit primar, për herë të parë në 25 vite, në nivelin +0.7 % e PBB-së. Pra në vitin 2017 shpenzimet për aktivitetet e qeverisë do jenë më të ulta se të ardhurat buxhetore.

Financuar nga:



Ministria e Financave

Bulevardi 'Dëshmorët e Kombit', Nr.3
Tiranë



<http://www.financa.gov.al/>

Tel: +355 4 223 0803
Fax: +355 4 222 8405